



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

**NJOFTIM**

**PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT PROKUROR TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Në mbështetje të neneve 111 e vijues të ligjit nr.115/ 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas përfundimit të verifikimit të kandidaturave të prokurorëve Esmeralda Keshi (Cami) e Vladimir Mara,

Njoftohen prokurorët e prokurorive të gjithë niveleve se, **më datë 04.10.2019, ora 10<sup>00</sup>, në Hotel “Tirana”, Salla “Balsha” Tiranë**, thirret Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, për zgjedhjen e anëtarit prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në bazë të nenit 112 të ligjit nr.115/2016, pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të prokurorëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është e detyrueshme. Përrjashtohen nga ky detyrim, prokurorët që për arsye të garantimit të shërbimit të gatishmërisë në prokurorinë përkatëse ose për arsye të tjera objektive, nuk mund të jenë të pranishëm.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ARTA MARKU**



**Tiranë më, datë 26.09. 2019**